



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402170/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për ndryshimin dhe përmirësimin e dispozitave të Kodit Rugor të Republikës së Shqipërisë*

Drejtuar : **Ministrit të Punëve të Brendshme
Z. Saimir TAHIRI**

**Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës
Z. Edmond HAXHINASTO**

Tiranë

Të nderuar Zotërinj Ministra,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë disa shoqëri tregtare të cilat ushtrojnë aktivitetet në fushëm e dhënies së automjete me qira, si "A.", "E.", "H.", "S.", "A." dhe "E.".

Sipas këtyre shoqërive, kur është hartuar fillimisht Kodi Rugor i RSH-së, dhënia e automjeteve me qira ishte një veprimtari ekonomike që zinte një peshë të papërfillshme në tregun e shërbimeve në vendin tonë. Ndërsa aktualisht kjo veprimtari është shndërruar në një sektor mjaft i rëndësishëm, dhe numërohen rreth 3000 automjete të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Nëpërmjet kësaj ankese shoqëritë e cituara më sipër ngrenë shqetësimin për shkak të disa problemeve që iu ka sjellë në punën e tyre aplikimi i disa prej dispozitave të Kodit Rugor. Sipas dispozitave aktuale për shkeljet e dënueshme me gjobë, si masë administrative, qiramarrësi përgjigjet solidarisht me qiradhënësin (Neni 194 – Parimi i Solidaritetit).

Në zbatim të kësaj dispozite, Policia Rrugore po u bllokoi gjithmonë e më shpesh automjetet që ato kanë në pronësi apo në përdorimin (për arsye të kontratave të qirave financiare/leasing me institucionet kredidhënëse). Këtë veprim Policia Rrugore e kryen, për shkak të shkeljeve apo kundravajtjeve që nuk janë kryer prej tyre, por nga qiramarrësit e automjeteve që ato disponojnë.

Automjetet që këto shoqëri disponojnë janë mjetet me të cilat ato krijojmë të ardhura, pra ato janë mjete pune. Në këtë rast këto shoqëri jo vetëm që po privohen nga e drejta për të punuar e për të krijuar të ardhura, por ndërkohë paguajmë edhe edhe gjodat administrative që nuk u takojnë atyre, duke rritur padrejtësisht shpenzimet e kompanive që ushtrojnë aktivitetet tregtar në këtë sektor.

Aktualisht automjetet e tyre po bllokohen, ju merret Leja e Qarkullimit nga Policia Rrugore dhe ato po pengohen në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregtar. Këto shoqëri disponojmë të gjithë dokumentacionin (kopje origjinale të Kontratës së Qirasë, si dhe fotokopje të Letërnjoftimit dhe të Lejes së Drejtimit të qiramarrësit) dhe mund të vërtetojmë në çdo kohë se kush e ka kryer kundravajtjen. Këtë dokumentacion ato mund ta venë në dispozicion të Policisë Rrugore, por faktikisht është e pamundur të gjejmë zgjidhje për këtë çështje me organet e Policisë Rrugore dhe absurditeti vijon, ato paguajmë gjoda pa qenë kundravajtës, dhe ato së bashku me automjetet e tyre shpallen “fajtorë” për kundravajtje të kryera nga qiramarrësit.

Gjithashtu ankuesit shkruajnë se, kur ndodh ndonjëherë që qiramarrësit e automjeteve të tyre të kryejnë ndonjë aksident me dëme njerëzore, ata merren menjëherë të pandehur dhe askush nuk e quan automjetin “fajtor”, siç ndodh në rastin e kundravajtjeve të dënueshme me gjodë. Sipas tyre, ky është një nonsens ligjor, në rastin e aksidentit (të kryerjes së veprës penale) është fajtor drejtuesi i automjetit, ndërsa në rastin e kundravajtjes administrative konsiderohet “fajtor” automjeti.

Për shkak të shkeljeve të dispozitave të Kodit Rrugor nga qiramarrësit dhe ndërhyrjes së Policisë Rrugore ato detyrohen të paguajmë gjoda që nuk u takojnë faktikisht duke u sjellë dëm të konsiderueshëm biznesit të tyre.

Sipas ankuesve, aplikimi on-line në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk krijon asnjë lehtësi për këto shoqëri, pasi gjodat shfaqen pas disa ditësh, dhe në rastin më të shpejtë një ditë më vonë, por gjithmonë pasi qiramarrësi e ka dorëzuar automjetin e marrë me qira, kontrata është mbyllur dhe të dyja palët kanë deklaruar që gjithçka është në rregull.

Përveç sa më sipër ankuesit shkruajnë se, zgjidhja e këtij problemi do të ishte mjaft e thjeshtë nëse do të merrej parasysh përvoja e vendeve të tjera, ku automjeti asnjëherë nuk trajtohet si “kundravajtës” dhe të bllokohet, sikurse ndodh tek ne. Pra ai shërben si element asociues me kundravajtësin, duke përdorur të dhënat e automjetit vetëm për të identifikuar kundravajtësin. Në këtë rast nuk është e nevojshme që të shpiket ndonjë gjë e re, por si kudo në vendet europiane edhe në vendin tonë duhet të vendoset një mekanizëm ligjor i cili të mundësojë zëvendësimin e targës së automjetit, me emrin e kundravajtësit, në sistemin e Policisë Rrugore, pas paraqitjes së dokumentacionit përkatës nga ana e kompanisë qiradhënëse.

Gjithashtu ankuesit shprehen se, “parimi i solidaritetit” është mjaft i vlefshëm për kompanitë apo institucionet ku drejtuesit e automjeteve janë edhe punëmarrës në këto ndërmarrje/institucione, por jo për kompanitë qiradhënëse

të automjeteve. Në rastin e këtyre kompanive ai bie ndesh me të drejtën themelore për të mos u ndëshkuar kur je i pafajshëm dhe të drejtën për të zhvilluar veprimtari ekonomike fitimprurëse.

Duke pretenduar se po iu shkelen të drejtat ligjore, ankuesit kërkojnë ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme duke i rekomanduar organeve kompetente ndryshimet e nevojshme në Kodin Rrugor të RSH-së.

Ne vlerësojmë se shqetësimi i ngritur nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin tregtar të dhënies së automjeteve me qira për shkeljen e të drejtave ligjore për shkak të dispozitës së Kodit Rrugor që parashikon parimin e solidaritetit është i drejtë. Ndërkohë gjykojmë se përmbajtja e kësaj dispozitë është shkak që krijon premisa për shkeljen e të drejtave të individit (person fizik apo juridik).

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e këtij problemi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, si dhe në nenin 24/a të Ligjit ku parashikohet se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve”*,

REKOMANDOJMË :

Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e projekligjit për disa ndryshime dhe përmirësime të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë me qëllim zgjidhjen e problemit të ankuesve dhe dërgimin e tij në Këshillim e Ministrave.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditore, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI